



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 4573 / datë 12 / 07 / 2013  
/ 3

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Nr. 7933, datë 12 / 07 / 2013

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR

PROCEDURAT, AFATET DHE DOKUMENTACIONIN E KËRKESAVE PËR  
NJOHJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE, SHOYRTIMIN E TYRE, SI DHE  
FORMËN DHE MËNYRAT E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR FITIMIN E  
SHTETËSISË SHQIPTARE NGA PERSONAT ME ORIGJINË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të nenit 7, nenit 25 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës", sipas kreut I, pika 3, dhe kreut II, pika 2, si dhe të kreut III pika 1, Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Punëve të Jashtme, në bashkërendim midis tyre,

**UDHËZOJNË :**

**I. Qëllimi**

Ky udhëzim parashikon procedurat që duhet të ndiqen për paraqitjen e kërkesës, të dokumentacionit të nevojshëm, plotësimin dhe përgatitjen e kërkesës për shqyrtim, afatet mbi trajtimin dhe njoftimin, regjistrimin e kërkesave për njohje ose fitim të shtetësisë, si dhe strukturat kompetente për paraqitjen dhe trajtimin e kërkesave, formën dhe mënyrën e plotësimin të kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare.

**II. Rregulla të përgjithshme mbi formën e kërkesës dhe përgatitjen e saj**

1. Kërkesa për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare duhet të bëhet me shkrim dhe si rregull, sipas formularëve me format të bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke u regjistruar në një regjistër të veçantë.

2. Kërkesa paraqitet pranë Ministrisë së Brendshme/Komisariateve vendore të Policisë së Shtetit, të vendqëndrimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, pranë përfaqësive diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit ose në përfaqësi të tjera në vendin ku interesuari banon apo ndodhet fizikisht.
3. Strukturat e Ministrisë së Brendshme në bashkëpunim me ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme përgatisin materialin informues, si dhe krijojnë të gjitha lehtësitë strukturore e praktike për dhënien e informacionit, formularëve në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë të informacionit, apo informacioneve shpjeguese.
4. Brenda çdo viti kalendarik, Strukturat e Ministrisë së Brendshme në bashkëpunim me ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme takohen të paktën një herë në vit për përmbushjen e këtij detyrimi dhe pas kësaj hartojnë një relacion drejtuar ministrave përgjegjës në lidhje me problematikat e hasura, masat e marra dhe përmbushjen e këtij detyrimi.
5. Në varësi të problematikave që vërehen në ecurinë e kërkesave, struktura përgjegjëse për Shtetësinë, konsultohet të paktën një herë në vit me strukturën përgjegjëse për çështjet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke bërë edhe përditësimin e informacionit.
6. Struktura përgjegjëse për shtetësinë si dhe struktura përgjegjëse për çështjet konsullore të Ministrisë së Punëve të Jashtme, janë të detyruara të bëjnë publike dhe të shumëfishojnë, në sasi të mjaftueshme dhe me mënyra të përshtatshme, dokumente që lehtësojnë informimin mbi rregullat, procedurat dhe mënyrat se si mund të merren formularët e ndryshëm, shpjegime për qëllimin dhe përmbajtjen e tyre apo të dokumenteve dhe të vërtetimeve të nevojshme për plotësimin e formularëve.
7. Funkzionarët publikë të ngarkuar për pranimin e aplikimit duhet të ndihmojnë të interesuarit dhe të kujdesen për plotësimin e aplikimit. Sipas rastit, funksionarët e ngarkuar për pranimin e aplikimit që pranojnë aplikimin, kanë detyrimin të orientojnë në mënyrë sa më të kuptueshme, duke e ndihmuar subjektin në paraqitjen e kërkesës, plotësimin e formularit në mënyrë sa më korrekte, dhe informimin e subjektit në lidhje me ecurinë e praktikës.
8. Formulari i kërkesës përmban:
  - a) Emrin,
  - b) Mbiemrin,
  - c) Atësinë,
  - d) Mëmësinë,
  - e) Datëlindjen,
  - f) Vendlindje,
  - g) Shtetësi (nëse ka),

- h) Gjendjen Civile,
- i) Adresën e saktë të vendbanimit jashtë territorit të Republikës të kërkuarit,
- j) Adresën e vendqëndrimit në Republikën e Shqipërisë nëse disponon,
- k) Datën e paraqitjes së kërkesës,
- l) Shkakun e kërkesës,
- m) Listën e dokumenteve mbështetëse,
- n) Nënshkrimin e kërkuarit ose përfaqësuesit të tij,
- o) Nënshkrimin e funksionarit të autorizuar për marrjen e aplikimit,
- p) Mendimin e funksionarit sipas rubrikës,
- q) Shënimet e funksionarit,
- r) Fotografi.

9. Formularit të kërkesës i bashkëlidhet:

- a) dokumenti i identifikimit dhe/ ose të gjendjes civile të shtetit të huaj të kërkuarit, si certifikatë e lindjes apo familjare.
- b) dokumentacioni mbështetës mbi bazën e të cilit pretendohet, shkaku ligjor për të cilin aplikohet.
- c) Dëftesa e pagimit të tarifës për shërbimin të parashikuar për secilën kërkesë sipas Udhëzimit nr. 6252 date 10.12.2001, "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rifitimin dhe heqjen dore nga shtetësia shqiptare", të ndryshuar
- d) nëse kërkuari dëshiron jetëshkrimin e tij.

10. Kërkuari ka detyrimin të deklarojë të dhëna, informacione dhe/ose paraqesë dokumentacion të saktë e të rregullt, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ai duhet të japë pëlqimin për trajtimin e të dhënave personale për qëllimin e trajtimit të kërkesës.

11. Struktura përgjegjëse për shtetësinë, nëse nuk arrin të rregullojë vetë të metat apo parregullsitë e kërkesës, gjatë shqyrtimit të kërkesës apo plotësimit në dokumentacion të saj, mund t'i kërkojë kërkuarit paraqitjen e çdo dokumentacioni të nevojshëm për plotësimin e kërkesës të nevojshëm për marrjen e një vendimi lidhur me të.

### III. Paraqitja e kërkesës për njohjen e shtetësisë shqiptare

12. Kërkesa për njohjen e fitimit të së drejtës së shtetësisë shqiptare paraqitet pranë Komisariateve vendore të Policisë së Shtetit, të vendqëndrimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, pranë përfaqësive diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit ose në përfaqësi të tjera në vendin ku interesuari banon apo ndodhet fizikisht.

13. Gjatë depozitimit të kërkesës pranë Komisariateve të Policisë vendore, dhe përfaqësive Diplomate ose Konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, funksionari i autorizuar para se të pranojë kërkesën,

kujdeset për identifikimin e subjektit aplikues dhe vërteton nënshkrimin e kërkuarit.

14. Autoriteti përgjegjës i Komisariateve të Policisë vendore, si dhe ai i Përfaqësive Diplomatike ose Konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, apo ai i përfaqësive të tjera në vendin ku interesuari banon apo ndodhet fizikisht, kryen verifikimin paraprak mbi rregullsinë formale të kërkesës dhe të të dhënave të deklaruara, dokumentacionit të huaj, duke bërë sipas rastit, në rubrikën përkatëse shënimet dhe dhënien e mendimit mbi kërkesën e paraqitur.
15. Kërkesa, së bashku me dokumentet shoqëruese, duhet të përcillet brenda 15 ditëve pune pranë strukturës kompetente për shtetësinë, në Ministrinë e Brendshme me rubrikën e plotësuar mbi dhënien e mendimit nga funksionari i ngarkuar për pranimin, dhe kur është e rastit edhe me shënimet përkatëse nga funksionari përgjegjës që ka bërë pranimin e aplikimit. Hapa të veçanta procedurale për secilën kërkesë parashikohen në këtë udhëzim.

#### **IV. Shqyrtimi i kërkesës për njohjen e shtetësisë shqiptare dhe afatet**

16. Me mbërritjen e kërkesës në Ministrinë e Brendshme, krijohet fashikulli i veçantë për secilën praktikë dhe bëhet regjistrimi i saj në regjistër.
17. Verifikimi i kërkesës i nënshtrohet procedurave administrative, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
18. Ministria e Brendshme, brenda 7 ditëve nga mbërritja e praktikës pranë saj shqyrton të dhënat e deklaruara dhe përbërësit familjarë që provojnë gëzimin e shtetësisë shqiptare të prindit apo të paralindurit të subjektit kërkuar në momentin e lindjes së kërkuarit.
19. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve për shtetësinë kanë karakter personal.
20. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve për shtetësinë dhe të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, dhe duhet të përdoren vetëm për qëllimin e aplikimit për shtetësinë shqiptare, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.
21. Procedurat e parashikuara në këtë kre zbatohen për:
  - a) personat e lindur nga të paktën njëri prind, që zotëronte shtetësinë shqiptare në momentin e lindjes së kërkuarit, pavarësisht nga vendi i lindjes;
  - b) personat, të paralindurit me shtetësi shqiptare të të cilëve nuk jetojnë më në momentin e paraqitjes së kërkesës, me kusht që të provohet

lidhja familjare në vijë të drejtë e personit kërkues me të paralindurin, i cili ka zotëruar shtetësinë shqiptare.

#### **V. Njoftimi i vendimit të Ministrisë dhe regjistrimi në gjendjen civile**

22. Kur vërtetohet se kërkuesi ka lindur nga njëri prind që ka pasur shtetësinë shqiptare në momentin e lindjes së kërkuesit, por që nuk është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile dhe nuk ka hequr dorë nga shtetësia, Ministri i Brendshëm në bazë të propozimit nga struktura përkatëse konstaton faktin e shtetësisë në bazë të lidhjes familjare dhe e dërgon për regjistrim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse kërkuesi nuk është i regjistruar, njofton atë dhe zyrën e gjendjes civile të interesuar e cila, kryen veprimet përkatëse për regjistrimin dhe dhënien e numrit personal. Në këtë rast, vendimi përkatës dhe numri personal i identifikimit, i njoftohet zyrtarisht kërkuesit.
23. Kur vërtetohet se i parëlinduri, mbi bazën e të cilit kërkuesi bazohet për njohjen e shtetësisë shqiptare, ka pasur shtetësi shqiptare dhe nuk ka hequr dorë prej saj, Ministri i Brendshëm në bazë të propozimit nga struktura përkatëse konstaton faktin e shtetësisë dhe e dërgon për regjistrim përbërësit e gjendjes civile të kërkuesit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Nëse kërkuesi nuk është i regjistruar, njofton atë dhe zyrën e gjendjes civile të interesuar e cila, kryen veprimet përkatëse për regjistrimin dhe dhënien e numrit personal. Në këtë rast, vendimi përkatës dhe numri personal i identifikimit, i njoftohet zyrtarisht kërkuesit.
24. Nëse personi i parëlindur nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile, fakti i zotërimit të shtetësisë shqiptare, mund të provohet me çdo certifikatë zyrtare, pasaportë, vendim gjyqësor, apo çdo dokument tjetër zyrtar që provon shtetësinë shqiptare e të paralindurit.
25. Fakti i provimit të lidhjes familjare, mund të provohet me çdo certifikatë zyrtare të gjendjes civile, certifikatë trashëgimie, vendim gjyqësor, apo çdo dokument tjetër zyrtar që provon këtë fakt.

#### **VI. Dokumentacioni dhe provueshmëria**

26. Si rregull, dokumentet e huaja kur paraqiten nga kërkuesi për shtetësinë shqiptare, duhet të jenë origjinale dhe të kenë Vulë Apostille në fletët origjinale në përputhje me Konventën e Hagës të datës 05.10.1961; ose dokumenti të jetë i legalizuar në fletën origjinale pranë përfaqësisë diplomatike apo konsullore të Republikës së Shqipërisë në shtetin ku është lëshuar.

27. Legalizimi bëhet në faqen e pasme të dokumentit origjinal, pas vulës që konfirmon dokumentin të autoriteteve të huaja të vendit të origjinës së kërkuesit.
28. Prova e origjinës shqiptare vërtetohet me çdo dokument në të cilin pasqyrohet ky fakt.
29. Lëvizja pa viza në territorin e zonës Shengen, apo qëndrimi me dokumentacion të rregullt provohet me çdo dokument në të cilin pasqyrohet ky fakt.
- VII. Mënyra e plotësimit dhe paraqitja e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare sipas nenit 9, pika "7" të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar**
30. Kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare paraqitet pranë Komisariateve vendore të Policisë së Shtetit, të vendqëndrimit të personit ose, në rast se personi banon jashtë shtetit, pranë përfaqësive diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit ose në përfaqësi të tjera në vendin ku interesuari banon apo ndodhet fizikisht.
31. Kërkesa përpilohet në formularin tip bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe duhet të përmbajë vetëdeklarimin për origjinën shqiptare.
32. Gjatë depozitimit të kërkesës pranë Komisariateve të Policisë vendore, dhe Përfaqësive Diplomate ose Konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit, ose i përfaqësive të tjera në vendin ku interesuari banon apo ndodhet fizikisht funksionari i autorizuar para se të pranojë kërkesën, kujdeset për identifikimin e subjektit aplikues dhe vërteton nënshkrimin e kërkuesit, duke bërë edhe shënimet përkatëse, më pas kërkesa evidentohet në regjistër.
33. Fakti i zotërimit të shtetësisë shqiptare, mund të provohet me çdo certifikatë zyrtare, pasaportë, vendim gjyqësor, apo çdo dokument tjetër zyrtar që provon shtetësinë shqiptare të të paralindurit ku mbështetet kërkuesi.
34. Procedurat e parashikuara në këtë kre zbatohen ndaj të huajve me origjinë shqiptare me shtetësi të një shteti anëtar të Bashkimit Europian apo që janë me qëndrim të rregullt në një shtet anëtar të Bashkimit Europian, ose me shtetësi të një shteti që mund të lëvizin pa viza në territorin e shteteve të zonës Shengen.
35. Dokumentacioni i paraqitur me kërkesën duhet të vërtetojë se personi:
- Është i paslindur, qoftë edhe nga një i paralindur me origjinë shqiptare dhe që nuk provohet se i paslinduri ka pasur shtetësinë shqiptare; ose

- ka pasur një të paralindur me shtetësi shqiptare, por që nuk përfiton shtetësinë shqiptare sipas procedurës së parashikuar sipas kreut 3 të këtij udhëzimi, për shkak të humbjes së shtetësisë së të paralindurit.
36. Procedura për aplikimin për dhënie e shtetësie shqiptare për interesa kombëtare, në bazë të nenit 9, pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 05.08.1998 "Për shtetësinë shqiptare", i ndryshuar, zbatohet kur rezulton se:
    - Personi ka mbushur moshën 18 vjeç;
    - ka mendim të strukturave të Ministrisë së Brendshme se nuk preket sigurimi dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë;
    - është plotësuar kërkesa së bashku me vetë-deklarim për origjinën shqiptare.
  37. Në kërkesë, kërkuuesi duhet të përcaktojë nëse aplikon vetëm apo edhe për fëmijët e tij.
  38. Dokumentacioni shoqërues i kërkesës duhet të vërtetojë se kërkuuesi rezulton të jetë i paslindur me lidhje familjare deri në tre shkallë nga një person me origjinë shqiptare, por që nuk ka shtetësi shqiptare në momentin e paraqitjes së kërkesës.
  39. Për fëmijën nën moshën 18 vjeç, prindi ose prindërit e të cilit aplikojnë sipas procedurës së parashikuar në shkronjën "c", të pikës 2, të kreut I, të Vendimit nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës" dhe sipas këtij udhëzimi, kërkesa për fitimin e shtetësisë shqiptare bëhet nga prindi ose prindërit.
  40. Nëse fëmija është në moshën 14 deri në 18 vjeç, kërkesa përmban edhe pëlqimin me shkrim të fëmijës.
  41. Formularit të kërkesës i bashkëlidhet:
    - e) dokumenti i identifikimit dhe/ose të gjendjes civile të shtetit të huaj të kërkuarit, si certifikatë e lindjes dhe familjare.
    - f) dokumentacioni mbështetës mbi bazën e të cilit pretendohet, shkakun ligjor për të cilin aplikohet.
  42. Procedurat e parashikuara në këtë Udhëzim nuk zbatohen në rastin e shtetasve të Republikës së Kosovës.

#### **VIII. Përgatitja e kërkesës për dhënien e shtetësisë shqiptare dhe afatet**

43. Me mbërritjen e kërkesës në Ministrinë e Brendshme, krijohet fashikulli i veçantë për secilën praktikë dhe bëhet regjistrimi i saj në regjistër.

44. Ministria e Brendshme shqyrton të dhënat dhe dokumentacionin e paraqitur, duke bërë verifikimin e shkaqeve dhe fakteve që janë të nevojshme mbi kërkesën.
45. Verifikimi i kërkesës i nënshtrohet procedurave administrative, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
46. Struktura kompetente për shtetësinë, brenda 7 ditëve nga mbërritja e praktikës, i përcjell kopje të dokumentacionit të dërguar nga kërkuesi duke i kërkuar informacion në lidhje me të dhënat e deklaruara, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.
47. Strukturat e Ministrisë së Brendshme paraqesin mendimin e tyre me shkrim Ministrit të Brendshëm brenda 7 ditëve pas marrjes së kërkesës në përputhje me këtë udhëzim.
48. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve për shtetësinë kanë karakter personal. Të dhënat individuale e familjare të përbërësve për shtetësinë dhe të gjendjes civile mund të kërkohen dhe të merren nga institucionet e organet, drejtpërdrejt nga shërbimi i gjendjes civile, dhe duhet të përdoren vetëm për qëllimin e aplikimit për shtetësinë shqiptare, duke u rezervuar në përhapjen e tyre, përveçse kur autorizohen me ligj.
49. Ministri i Brendshëm, pas relatimit të rastit, propozon dhënien e shtetësisë shqiptare personit me origjinë shqiptare, në bazë të pikës 7, të nenit 9, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, të ndryshuar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë pas paraqitjes së mendimeve sipas procedurës së parashikuar në Vendimin nr. 554, datë 03.07.2013, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave për njohjen ose fitimin e shtetësisë shqiptare nga personat me origjinë shqiptare, me përjashtim të shtetasve të Republikës së Kosovës" dhe në këtë udhëzim.
50. Vendimi i Ministrit të Brendshëm mbi propozimin e zgjidhjes së kërkesës i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës së bashku me praktikën e përgatitur në kushtet e pikës 7 të nenit 9.

#### **IX. Regjistrimi dhe pajisja me dokumente**

51. Pas nxjerrjes së Dekretit të Presidentit të Republikës për dhënien e shtetësisë shqiptare për interes kombëtar sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzim, zyra e Gjendjes Civile pa vonesë kryen procedurat e nevojshme për betimin dhe regjistrimin e shtetasit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, duke kryer në të njëjtën kohë çregjistrimin e personit nga regjistri kombëtar i të huajve, nëse ai ka qenë i regjistruar më parë në të. Personi i interesuar regjistrohet në Regjistrin



Kombëtar të Gjendjes Civile, pranë zyrës së gjendjes civile, për t'u pajisur më pas, me dokumente shqiptare.

52. Personat përfitues sipas këtij vendimi nuk janë të detyruar të lenë shtetësinë që kanë për të fituar shtetësinë shqiptare në Republikën e Shqipërisë apo të regjistrojnë një vendbanim në territorin e saj në momentin e regjistrimit të shtetësisë shqiptare në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

#### X. Ankimi administrativ dhe ankimi gjyqësor

53. Të interesuarit e legjitimuar mund të paraqesin ankim administrativ ndaj veprimeve të strukturave kompetente për trajtimin e kërkesës, në bazë të rregullave dhe afateve të parashikuara sipas Kodit të Procedurës Administrative.

54. Të interesuarit e legjitimuar mund të paraqesin ankim në gjykatë ndaj veprimeve të strukturave kompetente për trajtimin e kërkesës, në bazë të rregullave dhe afateve të parashikuara legjislacionit në fuqi.

55. Udhëzimi i përbashkët midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Rendit Publik, nr. 6252, datë 10.12.2001 dhe nr. 3583, datë 27.11.2001, "Për procedurat dhe dokumentacionin për fitimin, rritimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare", i ndryshuar, shfuqizohet vetëm, sa i përket rregullave ku parashikohen procedurat dhe dokumentacionin për fitimin e shtetësisë për personat me orgjinë shqiptare të parashikuara nga ky udhëzim.

56. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM

FLAMUR NOKA



MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME

ALDO BUMÇI

